



Të Bësh Ndryshimin

Komitetet Efektive të Auditimit në Kompanitë më të Vogla

Peter van Veen, Drejtor i Qeverisjes dhe Administrimit të Korporatës

Pse të shikojmë te komitetet e auditimit?

- Tregjet efikase dhe efektive të kapitalit kërkojnë të kenë besim në kornizën e qeverisjes së korporatës
- Komitetet e auditimit luajnë një rol kyç për të siguruar integritetin dhe transparencën e raportimit të korporatës
- Roli i tyre në shumë rajone është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, duke reflektuar gjithashtu ndryshimin e kërkesave rregullatore
- Komitetet e auditimit në tregjet më të vogla përballen me kufizime të veçanta (gjetja e anëtarëve të kualifikuar, sigurimi i mbështetjes së duhur)
- Pika kryeore e natyrshme për të kuptuar se si ka ndryshuar mjedisi i qeverisjes së korporatës...
- ... në një kohë kur fusha e përgjegjësisë së tyre shpesh po zgjerohet akoma më shumë me futjen e kërkesave të reja ligjore



Udhëzuesi për Kompanitë më të Vogla i ICAEW

ICAEW
IN ASSOCIATION WITH THE
FINANCIAL REPORTING COUNCIL

FRC



Smaller Listed and AIM Quoted Companies

A PRACTICAL GUIDE FOR AUDIT COMMITTEES
ON IMPROVING FINANCIAL REPORTING


icaew.com



Udhëzues për Kompanitë më të Vogla të Listuara

Një udhëzues praktik për Komitetet e
Auditimit

Cikli i Raportimit Financiar



PLANIFIKIMI

Pyetje për t'u konsideruar nga komiteti i auditimit

- Çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga procesi i raportimit financiar të vitit të kaluar?
- Çfarë veprimi është ndërmarrë për të siguruar që problematikat kryesore të raportimit financiar gjatë auditimit të vitit të kaluar të jenë më pak sfiduese këtë vit?
- A ka pasur ndryshime të standardeve të raportimit financiar gjatë vitit?
- A do të ketë nevojë për të bërë ndonjë ndryshim në politikat tona kryesore të kontabilitetit?
- A janë përshtatur sistemet tona për të marrë parasysh ndryshimet?
- Cilat janë rreziqet kryesore të raportimit financiar të kompanisë për këtë vit?
- A ka ndonjë transaksion të pazakontë ose fusha të gjykimit të rëndësishëm që do të ndikojnë në përgatitjen e raportit vjetor dhe llogarive? Çfarë veprimesh janë ndërmarrë për të menaxhuar rreziqet e anomalive në deklarinë që mund të lindin nga këto?

Pyetje për t'i bërë audituesit të jashtëm

- A mund të shpjegoni arsyetimin e përdorur për planin dhe skedulën kohore të auditimit?
- Cili është këndvështrimi juaj për procesin dhe funksionin financiar?
- Cilat janë rreziqet kryesore të auditimit këtë vit dhe si ndikojnë këto në raportimin financiar?
- Cilat deklarime të informacionit shpjegues financiar janë me rëndësi kritike në lidhje me rreziqet kryesore të auditimit dhe pse?

HARTIMI I RAPORTEVE TË NDËRMJETME DHE VJETORE

Pyetje për t'i bërë audituesit të jashtëm gjatë auditimit

- Cili është qëndrimi dhe niveli i përkushtimit të ekipit drejtues ndaj raportimit financiar?
- A ka ndonjë rrezik të pidentifikuar që duhet të artikulojmë në raportin vjetor?

Pyetje për t'i bërë audituesit të jashtëm në takimin e përfundimit të auditimit

- A keni vënë re ndonjë ndryshim në cilësinë e raportimit financiar të kompanisë?
- Çfarë mund të bëhet për ta bërë procesin e raportimit financiar më efektiv?
- Cilat janë tre gjëra që kompania duhet të bëjë ndryshe?

RISHIKIMI I PERFORMANCËS

Pyetje për t'i bërë audituesit të jashtëm në një takim privat

- A i trajton përgjithësisht ekipi drejtues çështjet e ngritura gjatë auditimit?
- Cilat aspekte të pasqyrave financiare dhe shënimeve shoqëruese kanë nevojë për përmirësim?
- A janë identifikuar më parë këto çështje?
- A i keni diskutuar pikëpamjet tuaja me Drejtuesin Kryesor të Financave (CFO) dhe drejtorët e tjerë ekzekutivë?
- Si rezulton kompania jonë në këtë fushë në krahasim me kompani të tjera me madhësi të ngjashme?

FORMULIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITIN E ARDHSHËM

Pyetje për t'u marrë në konsideratë nga komiteti i auditimit

- Për çfarë informacioni ka mundësi që të interesohen investitorët aktualë dhe të ardhshëm? A ka boshllëqe në informacionin aktual që komunikon kompania?
- Çfarë informacioni dhe raportesh financiare dhe jofinanciare përdoren për qëllime të menaxhimit të brendshëm, dhe si rezulton ky informacion në krahasim me qëllimin dhe përmbajtjen e raportimit tonë të jashtëm?
- Si të sigurojmë që kompania është në përputhje me detyrimet e saj të raportimit?
- Si siguron komiteti i auditimit që ai është i përditësuar me kërkesat më të fundit të raportimit?

Pyetje për t'i bërë CFO-së dhe ekipit të financave

- Cili është niveli dhe lloji i burimeve për të cilat ka nevojë ekipi i financave, a është identifikuar ndonjë boshllëk dhe si mund të plotësohen ato?
- Çfarë njohurish, përfshirë kualifikimet financiare dhe kualifikime të tjera të rëndësishme, dhe përvoja sjellin në organizatë anëtarët e ekipit të financave dhe bordit?
- Si mund të sigurohemi që ekipi i financave të jetë në përputhje me kërkesat e zhvillimit të vazhdueshëm profesional (CPD)? A është kjo e dokumentuar dhe rishikuar?

- A është përputhja me kërkesat e CPD-së një tregues kyç i performancës brenda sistemit të vlerësimit të organizatës?
- Si identifikohen dhe adresohen boshllëqet e njohurive dhe nevojat për trajnim?
- Kur fillon planifikimi për fundvitin? Cilët faktorë e ndikojnë në këtë vendim dhe a mund të përmirësohet skeduli kohor?
- A kishte një skedul kohor të qartë për procesin e raportimit financiar të vitit të kaluar? A ishte realiste dhe a u realizuan proceset brenda afateve?
- Cilat janë afatet kryesore për këtë vit? Ku janë pikat e presionit dhe si do ta menaxhojmë këtë?
- Si do t'i mbledhim dhe grumbullojmë të dhënat e nevojshme për të qenë në përputhje me standardet dhe rregulloret e reja?
- Si të sigurojmë që sistemet e raportimit financiar vazhdojnë të jenë të fuqishme dhe të përshtatshme për qëllimin e tyre ndërsa kompania rritet?

Çfarë procesi është vendosur për të identifikuar gabimet dhe mospërputhjet në raportin vjetor, për shembull, midis seksioneve narrative dhe pasqyrave financiare?



Rritja e Rolit & Përgjegjësisë për Komitetet e Auditimit


Pritshmëritë janë në rritje

Përveç ofrimit të sigurisë për raportet financiare dhe auditimet e jashtme për palët e interesuara dhe rregullatorët, Komitetet e Auditimit pritet gjithnjë e më shumë të:

- Mbikëqyrin funksionin/aktivitetet e Auditimit të Brendshëm
- Sigurojnë që Kontrollat e Brendshme janë adekuate dhe respektohen
- Mbikëqyrin rezistencën e kompanisë ndaj goditjeve dhe proceset e menaxhimit të rrezikut
- Mbikëqyrin zbatimin dhe menaxhimin e programit të etikës dhe pajtueshmërisë
- Sigurojnë raportimin e informacionit Jofinanciar dhe që të dhënat e tij janë të sakta dhe të një standardi të mjaftueshëm

Palët e interesuara po presin gjithmonë e më shumë nga bordet dhe komitetet e auditimit

Modeli i Tre Linjave të Mbrojtjes



Burimi: IIA

Menaxhimi i riskut

- Komitetet e auditimit shpesh pritet të ofrojnë mbikëqyrje të proceseve të menaxhimit të rrezikut të kompanisë, rreziqeve dhe zbutjes së tyre
- Rreziqet e mbikëqyrura zakonisht mbulojnë të gjitha aspektet e ndërmarrjes, përfshirë:
 - Rreziqet komerciale
 - Rreziqet operationale dhe të zinxhirit të furnizimit
 - Rreziqet e krimit financiar / Kontrollat e brendshme
 - Rreziqet e sigurisë së të dhënave dhe kibernetike dhe privatësisë së të dhënave
 - Rreziqet e thesarit
 - Rreziqet rregullatore
 - Rreziqet e jashtme materiale si aspektet e klimës, gjeopolitikës, ekonomisë etj
- Testimi i rezistencës/elasticitetit

Etika & Pajtueshmëria

- Rritja e barrës rregullatore për kompanitë, për shembull:
 - Legjislacion kundër ryshfetit, kundër pastrimit të parave, sanksione dhe krime të tjera financiare të nxjerra nga shumë juridiksione (BE, MB, SHBA)
 - Direktiva e BE-së për Kujdesin e Duhur për Qëndrueshmërinë
 - Legjislacion tjetër për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të të Drejtave të Njeriut
 - Direktiva e BE-së për sinjalizimin
- Komiteti i Auditimit duhet të ketë të drejtën e mbikëqyrjes së programit të Etikës dhe Pajtueshmërisë.
- Zyrtari i pajtueshmërisë (ose personi që merr këtë rol) duhet të ketë akses të pakufizuar në komitetin e auditimit
- Komiteti duhet të ketë të drejtën e mbikëqyrjes e linjës së sinjalizimit (Speak Up).

Raportimi Jo-Financiar

- Zhvillimet e rëndësishme në pritjet e raportimit jofinanciar përbëjnë një sfidë për shumë kompani, të mëdha dhe të vogla
- Standardet ISSB synojnë të krijojnë raporte dhe procese të auditueshme
 - Konsultimet për klimën dhe qëndrueshmërinë kanë përfunduar
- Me kalimin e kohës, proceset e raportimit jofinanciar dhe auditimit do të pritet të kenë të njëjtën ashpërsi dhe mbikëqyrje si raportimi financiar.

86% e investitorëve të SHBA-së besojnë se kompanitë ekzagjerojnë ose keqdeklarojnë informacionin në raportimin e tyre jofinanciar (ESG) dhe 72% nuk besojnë se ato kompani do të përmbushin objektivat e tyre të deklaruara ESG

– Barometri Edelman Trust 2021



Anketa e Komiteteve të Auditimit në Evropën Qendrore & Lindore

DISA PIKA KRYESORE DHE OBSREVACIONE

Anketa e Komiteteve të Auditimit në Evropën Qendrore & Lindore (2017)

- Nisma kërkimore e ICAEW dhe Deloitte u fokusua në Evropën Qendrore dhe Lindore
- Intervista me 30 anëtarë të komitetit të auditimit
- U mbuluan 38 njësi ekonomike me interes publik në një sërë sektorësh të ndryshëm, përfshirë shërbimet financiare, energjinë, bujqësinë dhe prodhimin
- Me struktura të ndryshme të korporatave, nga subjektet e listuara në nivel lokal deri të ato private, si dhe filialet e grupeve shumëkombëshe dhe disa ndërmarrje shtetërore
- Në 7 vende (Bullgari, Republika Çeke, Hungari, Lituani, Poloni, Rumani dhe Slloveni)

Si perceptohen në rajon komitetet e auditimit?

- Komitetet e auditimit po evoluojnë nga subjekte formale, juridike në ato më profesionale dhe të pavarura
- Po fokusohen gjithnjë e më shumë në çështje thelbësore, duke sfiduar ekipin drejtues dhe audituesin ligjor
- Por jo të gjithë po evoluojnë me të njëjtin ritëm
- Rritja e profilit të komiteteve të auditimit në rajon mbetet një punë në progres
- Kërkesat rregullatore (BE) kanë qenë një shtytës kryesor për ndryshim, përtej nevojave të biznesit ose kërkesave të investitorëve



Anëtarët e komitetit të auditimit duhet të jenë të pavarur dhe të kenë një këndvështrim global mbi performancën (Hungari)

Anëtarët e komitetit të auditimit tani duhet të kenë formim financiar DHE ekspertizë në industrinë përkatëse (Lituani)

Unë do të doja të forcoja nivelin e angazhimit me aksionarët në të ardhmen (Hungari)

Cili është perceptimi për punën e komiteteve të auditimit?

- Aftësitë e kërkuara nga anëtarët e komitetit të auditimit po ndryshojnë – më shumë kompetencë profesionale, më shumë njohuri të industrisë, pikëpamje më të pavarura
- Koha e shpenzuar nga anëtarët e komitetit të auditimit gjithashtu po rritet (përgatitje/në mbledhje)
- Ka sfida në gjetjen e anëtarëve të mundshëm të komitetit të auditimit me aftësi të përshtatshme profesionale dhe ekspertizë në industrinë përkatëse
- Ndërveprimet me entitetin e korporatës ndryshojnë, veçanërisht jashtë takimeve formale (në të cilat marrin pjesë Kryetari i Bordit, CEO, CFO dhe Drejtuesit e Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit të Brendshëm)
- Komunikimet me aksionerët gjithashtu ndryshojnë, duke reflektuar struktura të ndryshme pronësie dhe korporative
- Analiza të performancës janë kryer nga më pak se gjysma e komiteteve të auditimit të anketuar



Komiteti i auditimit ushtron ndikim. Rreziqet janë të njohura dhe ekziston një mbikëqyrje e duhur e përgjigjes së kompanisë (Rumani).

Rreziku duhet të jetë në axhendë, në një mënyrë që nuk ka qenë në të kaluarën (Republika Çeke)

Sfida më e madhe do të jetë shikimi i rrezikut të TI-së, përfshirë çështjet e sigurisë së të dhënave (Hungari)

Si po ushtrojnë ndikim komitetet individuale të auditimit?

- Komitetet e auditimit përmbushin gjerësisht rolin e tyre, veçanërisht në lidhje me kompetencat kryesore:
 - Raportimi financiar
 - Kontrolli i brendshëm
 - Auditimi i brendshëm
 - Menaxhimi i riskut
 - Procesi i auditimit ligjor
- Qasje të ndryshme janë evidente kur bëhet fjalë për menaxhimin e riskut – shumica nuk kanë komitete të veçanta të bordit
- Për sa i përket perspektivës, çështje të ngjashme mbeten në axhendë
- Një numër i vogël kanë filluar të fokusohen në mjedisin më të gjerë rregullator, të biznesit dhe ekonomik
- Megjithatë, çështjet në lidhje me sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe sinjalizimin në përgjithësi nuk janë në axhendë



Sfida më e madhe do të jetë zhvillimi i një roli normal për komitetet e auditimit – Unë pres që ky të jetë një proces i vazhdueshëm (Bullgari)

Njerëzit kanë filluar të kuptojnë se si komitetet e auditimit mund të kenë një ndikim. Aksionarët kanë filluar të përdorin ekspertizën që është në dispozicion të tyre brenda komiteteve të auditimit (Republika Çeke).

Komitetet e auditimit janë të dukshme dhe kanë autoritet në disa njësi ekonomike. Në njësi të tjera ekonomike, ato janë formale madje edhe jo-ekzistente (Rumani)



Faleminderit

